VENDIM
Nr. 254, datë 21.12.2021

MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 206, DATË 16.12.2019, "MBI MIRATIMIN E TARIFËS SË PËRKOHSHME TË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NGA SHOQËRIA 'ALBGAZ' SHA", PËR VITIN 2022

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 13, pika 1, nenit 16, pika 2, neni 17, germa "e", dhe të nenit 33, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar; nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; të "Metodologjisë për llogaritjen e tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 178, datë 18.11.2017, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 21.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 156/10 prot., datë 17.12.2021, e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, "Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, "Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria 'Albgaz' sh.a., për vitin 2022",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 60, datë 15.4.2019, vendosi "Miratimin e përkohshëm të tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria 'Albgaz' sh.a., prej 28 lekë/m^3 ose 2.6457 lekë/kwh deri më 31.12.2019".
- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, është miratuar lënia në fuqi e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 60, datë 15.4.2019, "Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria 'Albgaz' sh.a. për vitin 2020".
- Në zbatim të pikës 1, të nenit 21, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, dhe të pikës 1, të nenit 17, të "Metodologjisë për llogaritjen e tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 78/2017, Operatori i Transmetimit të Gazit Natyror duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim për miratimin e tarifave të reja në ERE, të shoqëruar me gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar sipas kësaj rregulloreje dhe metodologjive përkatëse.
- ERE, me shkresën nr. 987 prot., datë 4.10.2021, me lëndë: "Kërkesë për informacion", i është drejtuar shoqërisë "Albgaz" sh.a., që të marrë masa për përmbushjen e detyrimeve, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Shoqëria "Albgaz" sh.a., me shkresën nr. 138/1 prot., datë 1.12.2021 (me tonën nr. 987/1 prot., datë 1.12.2021) u përgjigj ndaj kërkesës së ERE-s, ndër të tjera, duke kërkuar që për vitin 2022 të mbetet në fuqi tarifa aktuale e transmetimit.
- Tarifa e shërbimit të transmetimit të gazit natyror është e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit nga shoqëria "Albgaz" sh.a., i cili ushtrohet konform ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, si dhe direktivave të Komunitetit të Energjisë, ku aksesi në rrjet për përdoruesit e sistemit të transmetimit duhet të jetë i garantuar dhe kjo shoqëri duhet t'i ofrojë shërbimet e saj me tarifa të rregulluara nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019, të Bordit të ERE-s, për vitin 2022, deri në miratimin e një tarife të mbështetur në aplikimin e shoqërisë "Albgaz" sh.a.

2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e kërkuara të shoqërisë "Albgaz" sh.a. nga të ardhurat e kërkuara të përkohshme, do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre, sipas përcaktimeve të nenit 17, germa "e", e ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar.

3. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti